



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 83

Prishtinë, më 7.11.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selvije Halimi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku dhe Pal Lekaj.

Munguan: Albulena Haxhiu, Danush Ademi, Valdete Bajrami dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Neppikanyas Sarp, Albana Gjinolli dhe Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; Eugen Cakolli, Violeta Haxholli dhe Jeta Krasniqi- KDI; Sanije Berisha, OSBE; Argjend Zejnaj, GP/AAK; Lumnije Murati- ZPRK; Ardian Bajraktari- MD; Gresa Ramadani- Vizitor; Shefki Kastrati- NDI; Driton Vitia- Kosova Sot; Elsa Zyberaj, Granit Berisha dhe Egzon Pacolli, praktikant.

Mbledhjen e kryesoi, Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Nga Staf i Mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 4 dhe 7 tetor 2016;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin për Akademinë e Drejtësisë;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-101 për performancën energjetike në ndërtesa;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/1-168;

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-100 për Ndhmën Shtetërore;
7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-117 për Akreditim;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime. Shqyrtimi i shkresës së kryetarit të Kuvendit lidhur me shqyrtimin e projektligjit për Kuvendin, Kërkesën e Qeverisë për plotësim ndryshimin e Procedurës Penale me procedurë të përshtetshme, Caktimi i ekipit që do të shkojë në vizitë në Lituaninë dhe caktimi i anëtarëve në grupin e përbashkët punues me Komisionin për të Drejtat e Njeriut për raportin e Avokatit të Popullit.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me 4 dhe 7 tetor 2016

Kryesuesja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura me 4 dhe 7 tetor 2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin për Akademinë e Drejtësisë

Kryesuesja e ftoj kryesuesin e grupit punues, z. Agim Aliu, që ta arsyetojë raportin me amendamente.

Agim Aliu Në fjalën e tij tha se kemi punuar një kohë të gjatë duke shqyrtuar në mori adresimesh nga mekanizma në të cilën interferon drejtpërsëdrejti ky projektligj . Ky projektligj është për herë të parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës i cili mëton të rregullojë çështjet si objektive dhe si përmbajtje. Konsideroj që është një projektligj që i ka realizuar të gjitha qëllimet dhe objektivat për çfarë edhe është hartuar nga sponsorizuesi dhe është amendamentuar nga ne dhe nga institucionet që kanë marrë pjesë në Grup Punues. Ky projektligj i ka gjithsej 39 amendamente dhe ne jemi kujdesur që ky projektligj të qëndroj gjatë dhe të realizojë ato objektiva dhe qëllime që i ka vënë vetes përpara. Gjatë kësaj kohe kemi pas takime të shpeshta edhe me debate mospajtuese në çështje të caktuara duke pohuar se ne për herë të parë po e bëjmë këtë projektligj dhe ndoshta ka ndryshuar edhe aktorët pjesëmarrës gjatë fazës së punës por si do që jetë unë mendoj se këto amendamente janë më se të qarta dhe të artikuluar ndaj përkundër shkresës që ka ardhur nga Ministria e Drejtësisë nuk do duhet të kishte ndonjë dilemë. Në takimin e fundit që kemi pasur me Ministrinë e Drejtësisë e kemi qartësuar çështjen mundësisë se edhe gjyqtarë mund të jenë pjesë e Drejtorit të Akademisë së Drejtësisë por edhe çështjen e mandateve që gjyqtarët të jenë anëtarë të Këshillit Drejtues ku ne i kemi përcaktuar me dispozita kalimtare '6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, Këshilli Drejtues i Institutit Gjyqësor të Kosovës, do të fillojë me përbërje të re'. Ky projektligj me këto amendamente i plotëson kushtet që të procedohet në Kuvend dhe po i njëjti të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Meqë nuk kishe vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash (6 për dhe një abstenim) nxori këtë:

Përfundim

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit;
- II. Projektligji për Akademinë e Drejtësisë nr. 05/L-095 dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-101 për performancën Energjetike në Ndërtesa

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-101 për performancën energjetike në ndërtesa dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, Kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-101 për Performancën Energjetike në Ndërtesa dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168 dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, Kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe Ligjin nr.04/L-168 dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-100 për Ndhmën Shtetërore

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-100 për Ndhmën Shtetërore dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-100 për Ndhmën Shtetërore dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-117 për Akreditim

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr. 05/L117 për Akreditim dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-117 për Akreditim dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8. Të ndryshme

A. Shkresa e kryetarit të Kuvendit për Ligjin për Kuvendin

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim shkresën e kryetarit të Kuvendit për Ligjin për Kuvendin dhe ftoi z. Armend Zemaj, si kryetar i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit.

Armend Zemaj tha se do të mbajmë një punëtori këtë muaj për Projektligjin për Kuvendin dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit duke pohuar se do të sqarojmë edhe pozicionin për projektligjin për Kuvendin se si do të procedojmë pasi kemi marrë edhe disa rekomandime nga Komisioni Evropian që ka të bëjë me reformën për administratën në përgjithësi, por për ne drafti është i

përfunduar. Më tej z. Zemaj i ftoi anëtarët që të jenë pjesë e kësaj punëtori e cila do të realizohet më 22-23 nëntor në mënyrë që secili të japë kontributin e vet për këto dy drafte. Po ashtu z. Zemaj shtoi se projektligji për Kuvendin do të jetë gati në dhjetor për të vazhduar më tej për t'u proceduar në Komision dhe më pas për Kryesi kurse Rregullorja e Punës së Kuvendit kërkon një angazhim dhe konsensus pak më të madh.

B. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-126 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-126 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale dhe tha se kemi një kërkesë që të shkojmë me procedurë të përshpejtuar me një ndryshim të Kodit të Procedurës Penale, duke pohuar se një nen kërkohet që të plotësohet dhe ndryshohet ndaj ftoi anëtarët që të deklarohen se a janë dakord që në parim të aprovohet.

Armend Zemaj tha se jemi në mbikëqyrje të dy ligjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë në vend dhe sigurisht që jemi duke e krijuar një pasqyrë morale të nevojave dhe hasjen e vështirësive të implementimit të ligjeve në praktikë. E kam lexuar projektligjin dhe është një përkufizim i nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale ndaj unë pajtohem se është një mundësi më e mirë dhe është një sqarim që ju ka lejuar organeve të rendit sidomos prokurorisë për zgjatjen e periudhës kohore të hetimeve për veprat penale të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe për veprat e tjera penale, të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen. Më tej z. Zemaj tha se ne duhet të jemi korrekt me veten se procedurat e përshpejtuara nuk na kanë dhënë produktivitet të madh në praktikë, por që nuk paraqet ndonjë problem të madh pasi që është vetëm një nen për ndryshim.

Pal Lekaj potencoi se sa i përket procedurave mendoj se çdo procedure e ngutshme nuk sjell ndonjë përmirësim dhe nuk e trajton temën ashtu si duhet të trajtohet prandaj derisa është procedure e përshpejtuar dhe nuk kam konsulta paraprake do të abstenoj.

Kryesuesja në fjalën e saj të serishme tha se nuk paraqet pengesa ndryshim plotësimi i këtij projektligji pasi që një nen ndryshohet por të njëjtën kohë të bëjmë apel te Qeveria që projektligjet e fushës kaq të ndjeshme të mos na vinë me procedurë të përshpejtuar.

Agim Aliu paraqiti shqetësim për përshpejtim të procedurave për ndryshim plotësimin e ligjit duke pohuar që Qeveria në procedimin e projektligjeve duhet të jetë pak më serioze sepse për një ligj ka shumë ndryshim plotësime dhe vërtet që për një ligj po bëhet një material voluminoz.

Pas diskutimeve kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash 6 për dhe 1 abstenim vendosi që Kuvendit t'ia paraqes këtë:

Rekomandim

1. Të miratohet në parim Projektligji nr. 05/L126 për ndryshim dhe plotësimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale.
2. Pas miratimit në shqyrtim të parë. Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, duhet ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.
3. I rekomandohet Kuvendit shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, që shqyrtimi i Projektligjit të bëhet me procedurë të përsheptuar-shmangie nga afatet procedurale.
4. Shqyrtimi i parë dhe shqyrtimi i dytë bëhen në të njëjtën ditë.

C. Njoftim për vizitë në Letoni

Kryesuesja i njoftoi se një nga mbledhjet që kemi pasur më parë, kemi pasur në takim përfaqësuesit e UNDP- së, ku është diskutuar lidhur me Agjencinë Kundër Korrupsion e cila është në fushëveprim të Komisionit. Në kuadër të këtij takimi është diskutuar që të realizohet një vizitë në Letoni duke u përfaqësuar secili Grup Parlamentar me nga një deputet të cilët do të jenë pjesë e delegacionit që do të vizitojë Lituaninë më 12-15 dhjetor.

Pas diskutimeve kryesuesja, konstatoi se Komisioni vendosi që delegacioni për vizitë në Letoni të jetë në këtë përbërje:

Albulena Haxhiu- kryetare,
Danush Ademi- nënkryetar,
Agim Aliu –anëtar,
Armend Zemaj- anëtar,
Valdete Bajrami-anëtare.

D. Caktimi i anëtarëve në grupin e përbashkët punues me Komisionin për të Drejtat e Njeriut për raportin e Avokatit të Popullit

Kryesuesja i njoftoi se do të shqyrtojmë Raportin e Avokatit të Popullit së bashku me Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe sipas marrëveshjes nga Komisioni jonë duhet të shkojnë 2 anëtarë.

Lidhur me këtë Komisioni vendosi që të në grupin e përbashkët punues me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione të jenë:

*Albulena Haxhiu, kryetare dhe
Agim Ademaj, anëtar.*

Mbledhja përfundoi në orën 10:50.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi